



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 17 DATË 18 / 07 / 2022

PËR

PËR TRANSFERIMIN E PARCELAVE TË LIRA, PRONË SHTETËRORE, NË ZONËN DJ-B_B_1, NË ZONËN KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, BASHKIA DIVJAKË, NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2015 “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike,

KONSTATOI SE:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka konfirmuar parcela të lira pronë shtetërore, në zonën Dj-B_B_1, në Zonën Kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë;
- Parcelat e lira, pronë shtetërore, në zonën Dj-B_B_1, në Zonën Kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, gjenden të detajuara në Aneksin 1 të këtij vendimi.
- Parcelat e lira, pronë shtetërore, në zonën Dj-B_B_1, në Zonën Kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, sipas Aneksit 1 të këtij vendimi, mund të vihen në dispozicion të investimeve strategjike.

Për këto arsye,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Transferimin dhe përfshirjen e pronës së paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, kategoria e resursit “arë”, me vendndodhje dhe

sipërfaqe sipas Aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me institucion administrues Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS).

2. Pasuria e paluajtshme shtetërore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke qenë se ndodhet në një zonë të rëndësisë kombëtare për të cilën ka Plan të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare, të miratuar, të mos copëzohet dhe të jetë në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, të cilat kanë impakt të konsiderueshëm strategjik, ekonomik dhe social në zonë.
3. Në çdo rast, vënia në dispozicion e pronave të paluajtshme shtetërore, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, do të kryhet vetëm pasi të jetë verifikuar përputhshmëria e investimeve strategjike me dokumentet e planifikimit të territorit, si dhe me planet, politikat e strategjitë sektoriale shtetërore.
4. Në rastet kur investimet strategjike nuk përputhen me këto plane, Komiteti i Investimeve Strategjike, nëpërmjet Agjencisë, do të propozojë përshtatjen e tyre me qëllim realizimin e investimit strategjik.
5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të ndjekur, sipas VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015, procedurat dhe rregullat për transferimin dhe përfshirjen e pronave të paluajtshme shtetërore, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, në FPPMIS, me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO